



Komiteti për Komunitete
02. Nr. III
Deçan, dt. 11.11.2022

PROCESVERBAL

Mbledhja e dhjetë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 11.11.2022.
Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u, KFOR-i.
Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Raport nga ZLK;
3. Të ndryshme.

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Procesverbali miratohet njëzëri, pa vërejtje.

II. Raporti i ZLK-së.

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji, nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhesuar.

Ai, gjithashtu, njoftoj të pranishmit për disa nga aktivitetet e ZLK-së, siç janë: vizita e Elbert Krasniqit, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për përrurimin e asfaltimit të një rruge në Fshatin Gramaçel, lagje e komunitetit, investim i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; vizita e Zëvendës Ministrit Avdullah Dješević nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Fshatin Pemishte dhe Prapaçan, me qëllim të rregullimit të disa rrugicave në këto fshatra; vizita të rregullta nëpër shkolla fillore të Komunës së Deçanit për t'u informuar lidhur me vijueshmërinë e nxënësve të komuniteteve nëpër shkolla. Me këtë rast, u cek se kishte problem me dy familje të Komunitetit Egjiptian, fëmijët e të cilave kishin ndërprerë mësimin. Me propozimin e komisionit, u caktua një takim me familjarët e fëmijëve, përfaqësuesve të DKA-së Deçan, QPS-së Deçan dhe drejtorit të shkollës ku ndjekin mësimin nxënësit e lartcekur.

Kryesuesi i falenderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:
Artan Ismajlaj

Kryesuesi i mbledhjes
Shkelzen Berisha